

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Qerim Ademaj dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve F.G.1., S.G. e lindur H., F.G.2. dhe D.G. të gjithë nga fshati ..., Komuna e Pejës, të cilët i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “NN” Associates respektivisht A.N., avokat nga Peja, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, Rruga “Lidhja e Pejës” - 30.000 Prishtinë, për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 44.167 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.165/16 të dt. 29.11.2016, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt. 23.07.2018 mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.165/16 i dt. 29.11.2016, VËRTETOHET.

NDRYSHOHET aktgjykimi i atakuar vetëm në pjesën e dispozitivit, që ka të bëjë me llogaritjen e kamatës, ashtu që, gjykohet si vijon: me kamatë vjetore në lartësi prej 8 %, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, datë 29.11.2016 e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, pjesërisht aprovohet kërkesë padia e paditësve. Në paragrafin I të dispozitivit, DETYROHET Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, Rruga “Lidhja e Pejës”, (ish Fabrika e Amortizatorëve) 30000 Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 02.03.2016, paditësve F.G.1., S.G. e lindur Hoxha, F.G.2. dhe D.G. të gjithë nga fshati ..., Komuna e Pejës, t’iu paguaj shumën e gjithmbarshme prej 36.000 €, me kamatë siç është paraparë me nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë në lartësi prej 12 % duke filluar që nga dita e paraqitjes së padisë (09.06.2015), deri në paguarjen definitive dhe ate për:

Për dhimbjet e përjetuara shpirtërore, për humbjen e djalit respektivisht vëllait dhe ate:

- Babait F.G.1. shumën prej 10.000 €,
- Nënës S.G. shumën prej 10.000 €,
- Vëllait F.G.2. shumën prej8.000 €
- Motrës D.G. shumën prej8.000 €

Në paragrafin II të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditësit F.G.1. në emër të dëmit material i cili konsiston në shpenzimet e varrimit t'ia paguaj shumën në lartësi të përgjithshme prej 5.167 €, të gjitha këto me kamatë siç është paraparë në pikën I të këtij dispozitivi. Në paragrafin III, detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet kontestimore në shumën prej 1.519 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Me të njëjtin aktgjykim kërkesëpadia e paditësve përtej shumës së gjykuar më lartë e që ka të bëjë me dëmin jo material në lartësi prej 3000 €, refuzohet si e pa bazuar dhe ate për paditësin F.2., shuma prej 1000 €, paditësen S. shuma prej 1000 si dhe për paditësin Fadil në emër të dëmit material që konsiston në ngritjen e përmendores së mbi varrezës në lartësi prej 1000 €.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqit ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet apo lënda të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e autorizuara e paditësve, me propozim që ankesa të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e atakuar e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të paditurës, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se: me datën 02.03.2016 rreth orës 02:30 minuta në fshatin ... Komuna e Istogut është shkaktuar Aksidenti nga vetura e markës "Chevorlet" me targa te regjistrimit ... të cilën në ditën kritike e drejtonte H.(S.) J., i cili për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë kushteve të rrugës dhe deri sa ka hyrë në tejkalim e ka humb kontrollin ndaj veturës dhe rrokulliset disa herë duke përfunduar në një hendek jashtë rrugës. Si pasojë e këtij aksidenti ka vdekur tani i ndjeri D.G., djali përkatësisht vëllai i paditësve. Paditësit me padi kanë kërkuar kompensimin e dëmit jo material që konsiston në dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të humbjes së të afërmit si dhe dëmin material që konsiston në shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores dhe këtë nga shkak i aksidentit të komunikacionit që ka ndodhur në datën e sipër cekur.

Nga ana e të paditurës nuk është kontestuar baza e kërkesëpadiisë, por e njëjta ka propozuar si në procedurë jashtë gjyqësore, kompensimin e dëmit me ofertën për zhdëmtim në shumën prej 18.500 € e cila ofertë nuk është pranuar nga paditësit.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre konform dispozitës së nenit 8 të LPK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike se, në aksidentin e shkaktuar me datën 02.03.2016 rreth orës 02:20 minuta në fshatin ... të Komunës së Istogut, kishte vdekur djali respektivisht vëllai i paditësve tani i ndjeri D.G.. Aksidentin e ka shkaktuar vetura e markës "Chevorlet" me targa të regjistrimit ... të cilën në momentin kritik e ka drejtuar H. (S.) J.. Shumat e dëmit gjykata i ka caktuar duke e marrë parasysh moshën shumë të re të tani të ndjerit dhe bindjen e lirë të sajë konform nenit 323 të LPK-së.

Këtë gjendje faktike të çështjes, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 136, 169, 177,179 dhe 183 të LMD-së, si dhe nenit 26 të Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm të Auto

përgjegjësisë sa i përket kamatës si dhe neneve 449, 452 dhe 453 të LPK-së, dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson, se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarrim, nga se në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, janë paraqitë arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet me rëndësi vendimtare, për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore, se ky aktgjykim nuk përmban shkelje esenciale nga dispozitat e nenit 182 par.2 pika n) lidhur me nenin 160.4 të LPK-së, as zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga dispozita e nenit 154 dhe 200 të LMD-së, sikurse pa të drejtë pretendohet në ankesën e të autorizuarit të paditurës, e as shkelje tjera esenciale për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Po ashtu nuk qëndron pretendimi ankimor se, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike, sepse nga provat e administruara dhe të vlerësuar në këtë çështje juridike, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në tërësi dhe plotësisht gjendjen faktike, duke i përshkruar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar të gjitha detajet e këtij rasti. Siç rezultojnë nga shkresat e kësaj lënde, as nga e paditura nuk është kontestuar bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësve. Kontestuese për të paditurën kanë qenë vetëm lartësitë e zhdëmtimit të caktuar nga Gjykata për paditësit.

Gjykata e Apelit vlerëson se, është irelevante se në rastin konkret është lexua apo nuk është lexuar si provë aktgjykimi penal, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me vdekjen e një të riu, kështu që përgjegjësia ekskluzive është e të paditurës e cila i mbulon rastet të tilla. Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi se nuk është cekur shkalla e përgjegjësisë e të paditurës, sepse kjo përgjegjësi rezultojnë nga vet ligjet të cilat e kanë rregulluar këtë çështje ku BKS i mbulon të gjitha shpenzimet në situata të tilla, siç është rasti i paditësve.

Sipas Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka gjykuar kur në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e djalit të tyre D. prindërve të tij iu ka caktuar shumë prej nga 10.000 €. Po ashtu, edhe sa i përket vëllait F.2. dhe motrës D.G., drejtë është gjykuar shuma prej 8.000 € sepse lartësitë e tilla i cakton edhe praktika gjyqësore e gjykatave në Kosovë kohëve të fundit. Prandaj, pretendimet e tilla të paditurës u refuzuan nga Gjykata e Apelit si të pa bazuara. Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi se lidhur me shumën e precizuar, fare nuk e ka obliguar paditësin për pagesën e taksës gjyqësore, e si rrjedhojë është bërë tejkalmi i kërkesëpadisë, sepse në raste të tilla kur kemi të bëjmë me vdekje të personit, pretendime të tilla nuk qëndrojnë.

Me asnjë provë nuk është vërtetuar se në rastin konkret kemi përgjegjësi të ndarë, për shkak të kontributit të dhënë të tani të ndjerit D.G. në këtë aksident, sepse përgjegjësia dhe faji ekskluziv siç rezultojnë edhe nga provat e kësaj lënde, ka qenë i vetëdrejtuesit të automjetit Chervolet, të cilin e ka drejtuar H. (S.) J., i cili është shkaktuesi ekskluziv i aksidentit, nga pasojat e të cilit ka ardhur edhe deri te vdekja e tani të ndjerit D..

Mirëpo, sa i përket kamatës së gjykuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë, duke ia njohur paditësve kamatën në lartësi prej 12 % nga dita e paraqitjes së padisë 09.06.2016 e deri në pagesën definitive.

Në këtë pjesë Gjykata e Apelit e ndryshoi pjesën që ka të bëjë me kamatën, duke e detyruar të paditurën që dëmin jo material dhe material në shumën e përgjithshme prej 36.000 €, të gjykuar si në

paragrafin I të dispozitivit si dhe në paragrafin II të dispozitivit t'iu paguaj paditësve me kamatë vjetore 8 %, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë 29.11.2016, e deri në pagesën definitive. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

Prandaj, lidhu me lartësitë e dëmit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë, për paditësit të cilët kanë pësuar dhembje shpirtërore për shkak të vdekjes së të afërmit të tyre Gjukata e Apelit i vlerësoi si reale e të cilat sa do pakë do të jenë si satisfaksion për zvogëlimin e dhimbjeve shpirtërore të përjetuara nga paditësit për vdekjen e djalit përkatësisht vëllait të tyre D..

Me dispozitën e nenit 136 par.1 të LMD-së, parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”.

Me dispozitën e nenit 169 par.3 të LMD-së, parashihet se kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktoj që ai t'ia paguaj të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Në këtë rast e paditura shpërblimin e dëmit duhet t'iu paguaj prindërve përkatësisht vëllait dhe motrës së tani të ndjerit D.G..

Me dispozitën e nenit 177 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij.

Me dispozitën e nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së, në mënyrë decisive parashihet se “*për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatoj se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykoj shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material*”.

Sipas Gjukatës së Apelit, të gjitha këto janë arsyetuar në plotëni, nga gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar.

Gjukata e Apelit, vlerëson se në bazë të gjendjes së tillë të çështjes, i pranon konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjukatës së shkallës së parë, duke qenë se gjendjen faktike e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, e mbi këtë bazë drejtë i ka zbatuar dispozitat e të drejtës materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Meqë, aktgjykimi i gjukatës së shkallës së parë nuk është goditur në ankesë në pjesën refuzuese, në këtë pjesë aktgjykimi mbeti i pa shqyrtuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura, e në pajtim me dispozitat e nenit 200 dhe nenit 195 par.1 pika d) lidhur me pikën e) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 4906/2016 më dt. 23.07.2018

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI

Gëzim Lulluni